



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1168/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI33/17

Parashtrues

Jusuf Bleta dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për
çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-16-0179 , të
13 tetorit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar me postë në Gjykatë nga Jusuf Bleta, Nazim Bleta, Arsim Shuki, Vjollca Bajraktari, Besnik Shuki, Fevzi Shilik, Tyrkan Berisha, Hajridin Shilik, Urhan Shilik, Gjylten Ihtimani, Shyret Pirana, Shahdan Shilik, Nehari

Iggji dhe Nazim Potori të gjithë nga Prizreni dhe trashëgimtarë të tjerë tani të ndjerit Rasim B., ish nga Prizreni dhe Behar Shporta, Muhterem Muriq, Mudesir Mujo, Nersin Fusha, Hasar Fusha, Nesiman Shinik, Afrim Kula, Florija Geshmegji, Ferija Karajagdihi, Sevim Shehi, Izet Kovaqi, Orhan Kovaqi, Perihan Spahi, Erdohan Shilik dhe Erol Shilik të gjithë nga Prizreni dhe trashëgimtarë të tani të ndjerit Hasan Bleta, ish nga Prizreni, të përfaqësuar nga avokati Mas-har Pirana nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesit).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-16-0179, të 13 tetorit 2016 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS), të cilin përfaqësuesi i parashtruesve e ka pranuar më 21 tetor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 mars 2017, parashtruesit e dërgoi kërkesën nëpërmjet postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata)
6. Më 13 mars 2017, kërkesa u regjistrua në Gjykatë me nr. KI33/17.
7. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 24 prill 2017, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dokumentacion shtesë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).
9. Më 8 maj 2017, Gjykata e pranoi dokumentacionin shtesë të kërkuar.

10. Më 4 korrik 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 18 korrik 2006, me Aktgjykimin C. nr. 144/03, Gjykata Komunale në Prizren ka aprovuar padinë e H. B, Y. B. dhe A. M. (të gjithë të afërm e në lidhje gjaku me parashtruesit) dhe i ka shpallur pronarë të disa ngastrave kadastrale të cilat më parë janë evidentuar si pronë e KBI "Progresi" nga Prizreni.
12. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale në Prizren kundër H. B, Y. B. dhe A. M, duke kërkuar të drejtën e pronësisë në 1/3 e pjesës reale të asaj patundshmërie duke pretenduar se edhe ata janë trashëgimtarë të barabartë të paraardhësve të tyre dhe në një proces të mëhershëm gjyqësor të vitit 1996 të gjithë ata, si trashëgimtarë të paraardhësve të tyre, së bashku edhe me të paditurit janë bërë pronarë në pjesë të barabarta të një patundshmërie tjetër.
13. Parashtruesit kishin pretenduar se padia e ushtruar nga të afërmit e tyre H. B, Y. B. dhe A. M. pa përfshirjen e tyre ka qenë kundërligjore dhe e bazuar në dokumentacion të rrejshëm e të paplotë. Kjo padi është trajtuar në Gjykatën komunale, me nr. C. nr. 343/07.
14. Më 4 korrik 2007, KBI "Progres" nga Prizreni ka bërë propozimin në Gjykatën Komunale në Prizren dhe ka kërkuar rihapjen e procedurës në lëndën C. nr. 144/03, të përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të 18 korrikut 2006.
15. Më 26 shtator 2007, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin C. nr. 470/07 ka lejuar përsëritjen e procedurës dhe e ka prishë aktgjykimin e plotfuqishëm C. nr. 144/03, të 18 korrikut 2006 dhe ka vendosur që procedura të përsëritet nga pika fillestare, duke vendosur që të dy paditë edhe të parashtruesve edhe të të paditurve të bashkohen në një lëndë, e cila nga gjykata është trajtuar me numrin C. nr. 470/07.
16. Më 2 mars 2011, Gjykata Komunale në Prizren, pas vlerësimit të padive me Aktvendimin C. nr. 470/07 është shpallur jokompetente dhe lënda i është dërguar Dhomës së Posaçme të GJS në vendosje.
17. Më 30 qershor 2016, me Aktvendimin C-III-12-0683 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së është hedhur poshtë si e papranueshme padia e parashtruesve.
18. Më 8 gusht 2016, kundër Aktvendimit C-III-12-0683, parashtruesit paraqitën ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.
19. Më 13 tetor 2016, Kolegji e Apelit i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-I-16-0179, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe vërtetoi Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-12-0683, të 30 qershorit 2016.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesit pretendojnë se me aktvendimin e kontestuar atyre u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm sepse u është cenuar barazia e armëve në atë mënyrë që provat e pakontestueshme dhe të vërtetuara me vula noteriale lidhur me trashëgiminë nuk janë marrë për bazë, e gjithashtu disa nga parashtresat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) të paraqitura në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së dhe në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së nuk u janë dorëzuar parashtruesve si palë në procedurë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson nëse parashtruesit e kanë paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar kohor me këtë rast i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*
24. Në mënyrë që të verifikojë nëse parashtruesit kanë parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet datës së pranimit të vendimit të fundit nga ana e parashtruesve dhe datës së dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
25. “Vendimi i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit, normalisht do të jetë vendimi i fundit me të cilin ishte refuzuar padia e parashtruesve (Shih *Paul dhe Audrey Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendim i 14 marsit 2002).
26. Afati fillon të llogaritet nga vendimi i plotfuqishëm, si rezultat i shterjes së mjeteve adekuate dhe efektive për të siguruar korrigjimin e çështjes, që është objekt i ankesës (Shih *Norkin kundër Rusisë*, Kërkesa 2105/11, GJEDNJ, Vendimi i 5 shkurtit 2013 dhe shih, gjithashtu, *Moya Alvarez kundër Spanjës*, nr. 44677/98, GJEDNJ, Vendimi i 23 nëntorit 1999).
27. Përkitazi me ankesën e ushtruar kundër Aktvendimit AC-I-16-0179, të 13 tetorit 2016, Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtruesve sipas pohimit vetanak e ka pranuar më 21 tetor 2016 ndërsa kërkesën e parashtruesve të adresuar në Gjykatën Kushtetuese e ka dorëzuar në postë më 10 mars 2017, pra qartazi pasi

ka kaluar afati i paraparë me nenin 49 të Ligjit brenda të cilit një kërkesë individuale mund të paraqitet në Gjykatë.

28. Gjykata vëren se përfaqësuesit i parashtrësve ka qenë i vetëdijshëm për kalimin e afatit, por vonesën e ka arsyetuar me shkaqe të tija shëndetësore, duke i paraqitë Gjykatës edhe dokumentacion mjekësor me të cilin arsyeton gjendjen e tij shëndetësore, dhe nga Gjykata ka kërkuar që kërkesën ta trajtojë si të afatshme.
29. Pa dashur të kontestojë të dhënat lidhur me gjendjen shëndetësore të përfaqësuesit të parashtrësve Gjykata vëren se vendimin e fundit lidhur me rastin ai e ka pranuar më 21 tetor 2016, mirëpo Gjykata nga evidenca e saj e kërkesave të paraqitura pran sajë, konstatohet se po i njëjti avokat në cilësinë e përfaqësuesit me autorizim, për parashtrues të tjerë në Gjykatë ka paraqitur kërkesë më 24 nëntor 2016 dhe ka dorëzuar dokumentacion shtesë më 12 janar 2017 (rasti KI136/16, parashtrues T. J. e të tjerë), andaj Gjykata nuk mund të marrë për bazë justifikimin për tejkalimin e afatit ligjor.
30. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kishin autorizuar avokatin e lartpërmendur që ti përfaqësojë atë gjatë procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave tjera. Gjykata konsideron që veprimet procedurale të ndërmarra nga përfaqësuesi juridik i palës, sipas autorizimit konsiderohen të jenë veprime të vetë palës. Në këtë rast, veprimet e tilla përfshijnë edhe parashtrimin e kërkesave dhe ankesave si dhe pranimin e vendimeve gjyqësore (Shih rastet KI46/13, KI47/13, KI48/13 dhe KI68/13, parashtrues *Naim Morina, Bukurije Drançolli, Avdi Imeri dhe Genc Shala*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 korrikut 2013).
31. Në lidhje me si më sipër, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka konstatuar që "*shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për gabimet e avokatit të caktuar për ndihmë juridike apo të zgjedhur nga i akuzuari*" (Shih *Kamasinski kundër Austrisë*, nr. 9783/82, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1989, A. nr. 168). Në mënyrë analoge, Gjykata konsideron që autoritetet publike nuk mund të mbahen përgjegjëse për veprimet e avokatit, aq më tepër në rastin kur avokati është autorizuar nga vetë pala, në këtë rast parashtruesi.
32. Prandaj në këto rrethana të rastit konkret kërkesa është e pa afatshme, dhe Gjykata nuk mund të shqyrtojë pretendimet e ngritura lidhur me shkeljet e të së drejtës për gjykim të drejtë në të gjitha elementet e saj (shih, ndër të tjera, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese KI105/15, të parashtrësve *Mehmet Bajraktari dhe të tjerët*, të 19 dhjetorit 2016).
33. Bazuar si më sipër, rrjedh se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe deklarohet e papranueshme ..

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me 113,7 të Kushtetutës. nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1), b) të Rregullores së punës, , në seancën e mbajtur më 4 korrik 2017, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi